



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:220780

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753453

KE.nr.122/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit Ndërmarrja Private “Osmani Petrol”, me NUI:80265948, me seli në Obiliq, fshati Llazarevë, kundër të paditurit Republika e Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me objekt kontesti kompensim i dëmit në emër të shpronësimit të patundshmërisë, jashtë seancës me datën 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE, për të vendosur sipas padisë së paditësit Ndërmarrja Private “Osmani Petrol”, me numër të lëndës KE.nr.122/22 (C.nr.1847/14; 2019:220780), e datës 10.09.2014, kundër të paditurit Republika e Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me objekt kontesti kompensim i dëmit në emër të shpronësimit të patundshmërisë.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësi Ndërmarrja Private “Osmani Petrol”, përmes të autorizuarit të tij me datë 10.09.2014, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, kundër të paditurit Republika e Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që t’ia kompensoj paditësit fitimin e humbur për çdo muaj të afarizmit si dhe t’ia paguaj shumën e shpronësimit të paluajtshmërisë.

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Sipas nenit 13 par.1 nën par. 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale ( Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*.

Meqenëse në rastin konkret objekt shqyrtimi sipas padisë së paraqitur është kompensim i dëmit në emër të shpronësimit të patundshmërisë, rrjedhë se kërkesa është paraqitur për kompensimin e pronës së shpronësuar/ekspropriuar, e cila procedurë zhvillohet sipas Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore dhe meqenëse Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, është kompetent për të vendosur kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate dhe duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.122/22, datë 29.05.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.